



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.301/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike, me gjyqtarin Alajdin Tërshnjaku, në çështjen përmbartimore të kreditorit: NP. “ M...” me numër, me seli në magjistralen Ferizaj-Prishtinë të cilin e përfaqëson Avokate Arlinda Haziri, kundër debitorit: “K-B.....SHPK me numër të, me drejtorin M.B. me adresë në Malishevë, të cilin e përfaqëson avokati Naim Spahiu nga Prishtina, që ka të bëjë me pagesën e borxhit, si objekt i përmbartimit, duke vendosur sipas prapësimit të debitorit të ushtruar kundër Urdhrit të Përmbartuesit Privat Mubarak Shumolli P.nr.152/2020 të dt:19.02.2020, mbi caktimin e përmbartimit, me dt:29.08.2022, jashtë seance merr këtë:

A K T V E N D I M

I.APROVOHET si bazuar prapësimi i debitorit: “K-B.....SHPK me numër të, me drejtorin M.B. me adresë në Malishevë, të cilin e përfaqëson avokati Naim Spahiu nga Prishtina.

II.SHFUQIZOHET Urdhri i Përmbartuesit Privat Mubarak Shumolli P.nr.152/2020 të dt:19.02.2020, mbi caktimin e përmbartimit.

III.PËFUNDUHET, procedura përmbartimore KPPP.nr.301/22 dhe abrogohen të gjitha veprimet e ndërmarra në këtë çështje përmbartimore.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Përmbartuesi privat Mubarak Shumolli me seli të zyrës në Prishtinë, duke vepruar sipas propozimit për përmbartim të kreditorit ka lëshuar urdhër me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumenteve të besueshëm –Faturave Nr.fat:388/14 e datës:05.11.2014, Fat.nr. 387/14 e datës 05.11.2014, të cilat paraqesin dokument përmbartues në bazë të nenit 21 dhe nenit 29 par.1.3 të LPP-së.

Kundër urdhrit për lejimin e përmbartimit, debitori brenda afatit ligjor ka ushtruar prapsim. I autorizuar i debitorit në prapsim kishte theksuar se ne konsiderojmë se lejimi i propozimit për përmbartim në bazë të faturave të lartcekura është i palejueshëm pasi që nuk janë

plotësuar kushtet ligjore në bazë të Ligjit për Procedurën Përmbaremore për arsye se të gjitha faturat e prezantuara nuk janë pranuar nga ana e debitorit ashtu siç e parasheh ligji. Po ashtu i njëjti kishte theksuar se kërkesa e kreditorit është parashkruar duke u bazuar në nenin 352 paragrafi 1 të LMD-së ku theksohet se "*Kërkesat përshkruhen për pesë vjet, në qoftë se me ligj nuk është caktuar ndonjë afat tjetër i parashkrimit*".

Pra në kuptim të dispozitës ligjore të lartpërmendur konstatojmë se në rastin konkret kreditori e ka humbur të drejtën ligjore për paraqitjen e propozimit për përmbaremin në bazë të faturave si dokument i besueshëm sepse që nga data e lëshimit të faturave 05.11.2014 e deri në ditën kur kreditori ka parashtruar propozimin për përmbaremin kanë kaluar mbi 5 vite, pra ka kaluar afati i paraparë ligjor. Andaj bazuar në të lartcekura i autorizuari i debitorit i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit "K-B.....SHPK" nga Malisheva, si i bazuar dhe të abrogohet Urdhri përmbaremit i Përmbaremit Privat Mubarak Shumolli P.nr.152/2020, i datës 19.02.2020 si dhe të obligohet pala kreditore që debitorit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës përmbaremore dhe atë për prapësim shumë prej 104€.

Megenëse kreditori me propozimin për përmbaremin të parashtruar me datë 30.09.2020, ka kërkuar borxhin për faturat me numër nr.fat:388/14 e datës:05.11.2014 dhe nr. Fat. 387/14 e datës 05.11.2014, gjykata pas vlerësimit të afateve të parashkrimit lidhur me faturat e lartpërmendura, ka gjetur se për pagesat e të njëjtave, sa i përket borxhit, ka arritur parashkrimin i kërkesës, për arsye se borxhi rrjedhë nga data 05.11.2014, ndërsa propozimi për përmbaremin të Përmbaremit Privat është parashtruar me datë 19.02.2020, respektivisht pasi ka kaluar afati i parashkrimit më shumë se 5 (pesë) vite.

Gjykata, pasi bëri shikimin e shkresave të lëndës, analizoi dokumentet në bazë të të cilave përmbaremit ka lejuar urdhrin përmbaremit, fillimisht vlerësoi parashkrimin e kërkesës të pretenduar nga ana e debitorit, ju referua nenit 355 dhe nenit 352 të Ligji Nr. 04/L-077 të LMD-së të cilët nene parashohin afatin tre dhe pesë vjeçar të parashkrimit të kërkesave, vlerësoi se dokumentet e tilla nuk i përmbush kushte ligjore të parapara me dispozitat e nenit 27 të LPP-së, konkretisht nenit 29 par.3, pasi që dokumentet –faturat në bazë të së cilës është lejuar përmbaremit, nuk paraqesin dokumente të besueshme dhe si të tillë janë të pa përshtatshme për përmbaremin, pasi që të njëjtat e kanë arritur afatin e parashkrimit.

Gjykata vendosi që secila palë t'i bart shpenzimet e veta procedurale siç është vendosur në pikën -IV- të dispozitivit të këtij aktvendimi, konform dispozitave ligjore në bazë të nenin 17 të LPP-së lidhur me nenin 450 të LPK-së, me të cilën parashihet citoj "*Secila palë paraprakisht vetë i bartë harxhimet që i ka shkaktuar me veprimet procedurale të veta*".

Nga arsyet e paraqitura, në bazë nenin 352 par.1 të LMD-së, nenit 355 Ligji Nr. 04/L-077 të LMD-së, neni 43 par. 4 të dhe 73 të LPP-së si dhe për Plotësim Ndryshimin e ligjit e me numër Nr.05/L-118 të ligji 04/L-139 për Procedurën Përmbaremore, Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS-Dhoma e Shkallës së Parë-
Departamenti për Çështje Ekonomike
KPPP.nr.301/22, dt.29.08.2022

Gj y q t a r i
Alajdin Tërshnjaku

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi është e lejuar
Ankesa në afat prej 7 ditësh nga marrja e
të njëjti, përmes kësaj gjykate për
Dhomën e Shkallës së dytë të Gjykatës
Komerciale të Kosovës me seli në
Prishtinë.